



Departamenti: <b>Shitje Marketing</b>	Moduli: <b>Menaxhim</b>	Nr: _____
Prof: <b>Blerim Morina</b>	Detyra: <b>Kontrolli</b>	
Kompetenca: <b>Kontrolli i punve ne org.</b>	Kohëzgjatja: <b>30 minuta</b>	Metoda: <b>Grupe (4-5 persona)</b>

Agimi punonte tek “Xona” prej 5 viteve dhe kishte ecur mirë në pune duke zënë pozitën e analistit kryesor të programeve. Ai ishte i kenaqur nga kompania dhe nga puna me kerkesa të larta.

Gezimi erdhi për të punuar në departamentin e kontabilitetit financiar të një kompanie të madhe prodhimi. Ai kishte dy vjet eksperiencë pune në kontabilitet, por ja mori dorën punës shpejt dhe e bente shumë mirë atë si edhe pelqej nga mbikqyresit dhe shokët e tij të punës. Pas 11 muajsh ju ofrua një post në departamentin e kontabilitetit të kostos, me pagë më të mirë si dhe më mundësi për të zhvilluar profesionalisht në një fushë tjetër.

Edi ishte mbikqyres në departamentin e kontabilitetit të kostos. Edi ishte njëri që ka mesuar kryesisht vetë, punon shumë dhe u ngrit në pozite duke punuar me shumë se të tjerët dhe duke bërë punë të vështira. Pas tre muajve Gezimi e kuptoi që ai dhe Edi nuk mund të punonin së bashku. Gezimi nuk ishte dakord me teknikat e trainimit të Edit dhe me filozofinë e tij mbi menaxhimin se si duhet të zgjidheshin problemet e ndryshme. U bë e qartë se kishin edhe konflikte të ashpra Personaliteti.

Pas një muaji dilemë se çfarë të bënte, Gezimi vendosi që të shkonte tek mbikqyresi i Edit që ishte Gjergji dhe ta pyeste për ta transferuar. Ai i tha se donte të rrinte tek kjo kompani por as ai as departamenti ku ishte nuk po përfitonin gjë po të mos e ndryshonin vendin e punës. Edi dhe Gjergji kishin qenë miq dhe shokë pune prej shumë vitesh dhe reagimi i parë i Gjergjit ishte kritika ndaj Gezimit për situatën e keqe. Sidoqoftë ai pa pozitën e tjera në kontabilitet por asnjë vend i lirë nuk dukej. Gjergji mendoi se kishte tre alternative: të hapte një vend të ri kontabiliteti në një departament tjetër dhe të transferohej Gezimin, të punonte me Edin dhe Gezimin për t’i pajtuar ose të pushonte nga puna Gezimin.

Pyetje

1. Kush mund ta ketë shkaktuar konfliktin ndërmjet Gezimit dhe Edit? Si mund të kontrollohet ky konflikt me qëllim që të mos shkojë kundër opsioneve që kryhen në punë?
2. Çfarë veprimesh duhet të ndermarrë Gjergji? A është i limituar ai vetëm në tri alternative që mendoi?
3. Nëse ju do ishit në vendin e Gezimit çfarë do të bënit?